



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 112/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, paraqitur kundër Nismës për Kosovën dega në Suharekë, për shkak të vendosjes së posterëve në shtyllat e ndriçimit publikë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 04.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.06.2014, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, me të cilën pretendohet se më datë 02.06.2014, rreth orës 14:00 në Rrugën “Brigada 123” se “Nisma për Kosovën” ka vendosur poster të Shqipe Gashi në cilësinë e kandidatës për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës në hapësira të ndaluara respektivisht në shtyllat e ndriçimit publik, të cilat sipas parshtruesit të ankesës janë në pronësi publike dhe gjenden në rrugë publike, Mëtej parshtruesi i ankesës thekson se ky veprim është i ndaluar në bazë të dispozitës së Nenit 4.1 pikës (b) të Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me Nr. 11/2013.

Në cilësinë e provës parshtruesi i ankesës ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi, lidhur më pretendimet e theksuara në ankesë. PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, ka konstatuar nga shkresat e lëndës pretendimet ankimore se kandidatja për deputet në fjalë nga Nisma për Kosovën, ka rënë në kundërshtim më nenin 4 par. 1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së Nr. 11/2013 nuk qendërojnë sepse vendi ku është vendosur poster i kandidatës së Nismës është shtyll elektrike e jo shtyllë e ndriçimit publik siç pretendohet në ankesë. Prandaj në mungesë të provave lidhur me pretendimet e ankimore dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 112/2014 më datën 04.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Përndaj siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.